



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 43, Datë 06.03.2020

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SH.A. PËR SHTYRJE TË AFATIT TË
VENDIMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike” I ndryshuar, 53 pika 1 dhe 3, nenit 91 dhe 92 pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, nenit 24 pika 1 të Rregullores së Organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 06.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes nr. 37/2 Prot, datë 26.02.2020, mbi kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin Nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/55 Prot., datë 25.11.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 729/1 Prot., datë 03.12.2019, ka përcjellë pranë subjektit “ALBGAZ” sh.a., njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës si dhe mungesën e dokumentacionit të konstatuar në dosjen e aplikimit.
- Gjithashtu me shkresën nr. 84 prot., datë 16.01.2019, ERE i është drejtuar sërish shoqërisë me një kujtesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 288 Prot., datë 28.01.2020, ka paraqitur pjesërisht dokumentacionin lidhur me plotësimin e kërkuar, dhe plotësimi konsiston në vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, me nr. T01704822, datë 14.01.2020, nga i cili rezulton se shoqëria nuk ka detyrim tatimor të papaguar deri në datën e lëshimit të vërtetimit. Për këtë arsye ERE iu drejtua sërish shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., me shkresën nr.288/1 Prot, datë 04.02.2020, duke i rikërkuar plotësimin sipas kërkesave të rregullores të dokumentacionit të mbetur.
- Në vijim shoqëria “ALBGAZ” sh.a., me shkresën nr. 288/2 Prot, datë 08.02.2020, ka përcjellë në ERE kërkesën për shtyrje të vendimarrjes finale të Bordit, në pamundësi për ti plotësuar këto dokumenta brenda afateve dhe ka deklaruar se një pjesë e tyre është në proces përpilimi.

- Neni 24 i rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ere parashikon se: *Nese një person paraqet një kërkesë të ndryshme nga sa parashikohet në keto rregulla atehere ERE do të procedojë në përputhje me dispozitat që rregullojnë atë çështje sipas legjislacionit në fuqi.*
 - Në zbatim të nenit 53 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se *Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.*
 - *Afati i parashikuar në rregulloren e licencimit për marrjen e vendimit përfundimtar të bordit të ERE për miratimin apo refuzimin e kërkesës është 60 ditë.*
 - Në zbatim të nenit 53 pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.
 - Në zbatim të nenit 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:
 - 1) *Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.*
 - 2) *Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.*
 - Kërkuesi, ka paraqitur një kërkesë të arsyetuar, përpara përmbushjes së afateve të parashikuara për mbylljen e kësaj procedure në datën 03.03.2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 01.07.2020.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI